

Komunikatë për shtyp

Ballkani Perëndimor, 01 Qershor 2021

## Qeveria Gjermane vazhdon mbështetjen për fuqizim ekonomik në Ballkanin Perëndimor

*Organizata jo-qeveritare Gjermane Help - Hilfe zur Selbsthilfe (misionet në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi, Serbi) informon publikun për lansimin e programit mbështetës gjerman "Fuqizimi socio-ekonomik i Ballkanit Perëndimor" me vlerë 3.35 milion Euro*

Organizata jo-qeveritare Gjermane Help - Hilfe zur Selbsthilfe zbaton një program prej **3,35 milion Euro**, të mbështetur nga Gjermania përmes projektit "**Fuqizimi socio-ekonomik i Ballkanit Perëndimor**" për të përmirësuar dhe përkrahur stabilitetin socio-ekonomik të rajonit në 2021 deri në fund të Dhjetorit 2022.

Qëllimi është krijimi i mekanizmave dhe rrjeteve për fuqizimin e grupeve të marginalizuara, përfshirë masat e rimëkëmbjes nga COVID-19 në mënyrë që të mundësojë përfshirjen e tyre dhe prosperitetin shoqëror.

Fokusi i aktiviteteve, në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, është në krijimin e vendeve të punës përmes krijimit të bizneseve të reja dhe ofrimit të mbështetjes për ato ekzistuese të prekura nga COVID-19. Përkrahja do t'u ofrohet grupeve të cënueshme shoqërore përfshirë këtu gratë, të rinjt, anëtarët e komuniteteve jo-shumicë, personave me aftësi të kufizuara, të burgosurve dhe iniciativave lokale, përmes fuqizimit ekonomik në ndërtimin e aftësive personale dhe profesionale.

Deri në fund të projektit, pritet që në Ballkanin Perëndimor, Help do të mbështesë të paktën **470** biznese të vogla, **900** qytetarë do të kenë zhvilluar aftësitë e tyre personale dhe profesionale. Si dhe do të ofrohet mbështetje për **18** qendra korrektuese dhe të paktën **15** iniciativa lokale të përfunduara, dhe një platformë sociale plotësisht funksionale në nivel rajonal.

### **Timo Stegelmann, Zëvendës Drejtor Menaxhues në Help**

*"Duke ndjekur parimin e" Ndhmës drejt vetë-qëndrueshmërisë ", Help mbështet përpjekjet e familjeve me të ardhura të ulëta, grave, të rinjve, komuniteteve, të burgosurve dhe ish-të burgosurve, personave me aftësi të kufizuara për të përmirësuar kushtet e jetesës në bazë të mundësive të tyre për një qëndrueshmëri afatgjate. "*

## Kosovë

*Shqipe Breznica, Drejtoreshë Nationale*

*"Në Kosovë, Help do të vazhdojë përpjekjet në fuqizimin e mikro bizneseve me grante dhe të ofrojë trajnime biznesore dhe profesionale për të rritur kapacitetet e tyre si dhe për të lehtësuar qasjen në tregun e punës.*

*Shërbimet Korrektuese dhe Shërbimet Sprovuese të Kosovës do të mbështeten brenda komponentit të risocializimit. Sa i përket përmirësimit të komuniteteve lokale, kopshtet në kryeqytet do të mbështeten për të krijuar një mjedis më të mirë.*

*Për më tepër, strukturat lokale të krijuara më parë do të bashkëpunojnë përmes veprimit sinergjik për një të mirë të përbashkët për të prodhuar dhe ngritur kosha plehrash të vendosura në kryeqytetin e Kosovës, Prishtinë".*

###

*Më shumë informacion rreth projektit janë në dispozicion në / përmes:*

[www.help-kosovo.org](http://www.help-kosovo.org)

[www.facebook.com/helpkosovo](https://www.facebook.com/helpkosovo)

*Personi i kontaktus për media*

*Gent Saraçi*

Tel.: +383 38 704 302

Mob: +383 44 672 072

[saraci@help-kosovo.org](mailto:saraci@help-kosovo.org)